




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 232/2019

Datë: 6 nëntor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, nenit 16 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 18 dhe 21 të Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen nr. 226-të, të mbajtur me datë 6 nëntor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Komisioni për Çështje Normative, anëtarët e të cilit janë caktuar sipas Vendimit KGJK, nr. 19/2018, datë 15 shkurt 2018, ndryshon përbërje si vijon:
 - 1.1 Z. Gjimshit Galushi-anëtarë Rezervë i komisionit paraprak caktohet anëtarë i rregullt i Komisionit;
 - 1.2 Znj. Anita Krasniqi-Prenaj, anëtare e Komisionit, caktohet Kryetare e Komisionit, ndërsa
 - 1.3 Znj. Manusha Karaçi, caktohet anëtare Rezervë e Komisionit.
- II. Mandati i anëtarit të Komisionit është dy (2) vjeçar, i cili mandat mund të zgjatet vetëm një (1) herë.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 6 nëntor 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 6 nëntor 2019, ka ndryshuar përbërjen e Komisioni për Çështje Normative, meqë ky Komision ka mbetur pa një (1) anëtarë dhe Kryetare të Komisionit, ngase anëtari/Kryetari i këtij Komisioni z. Armend Berisha, ka dhënë dorëheqje nga funksioni i anëtarit të KGJK-së.

Me qëllim të funksionimit në përbërje të plotë të Komisioni për Çështje Normative, KGJK, caktoi z. Gjimshit Galushi, anëtar të rregullt të Komisioni për Çështje Normative, Znj. Anita Krasniqi, Kryetare të Komisionit, Znj. Manusha Karaçi, anëtare Rezervë të Komisionit me mandat dy (2) vjeçar.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtareve të Komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.

